



Pranuar / Dorezuar Pritjen / Prizato Received / Delivry	04.08	3	viti god year
Organ / Njësia Org / Jedinica Org / Unit	5544	2023	115



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.886/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, dhe Kaltrina Avdullahi-Prenaj-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.660/2022 të datës 27.06.2023 të parashtruar nga ankuesja [redacted] me adresë:

[redacted] kundër Vendimit me numër të referencës Ref. 02/Nr.148 të datës 19.06.2023 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregëtisë, në çështjen juridike "Kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 04.08.2023, mori këtë

V E N D I M

- I. **APROVOHET** si e bazuar ankesa me numër A.nr.886/2023 e datës 27.06.2023 e parashtruar nga ankuesja [redacted]
- II. **SHFUQIZOHET** Vendimi me numër reference Ref.02.Nr.148 i datës 19.06.2023 i Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregëtisë.
- III. **OBLIGOHET** Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregëtisë, që të bëjë zbatimin e këtij Vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij Vendimi, duke e kthyer ankuesen në pozitën "Asistente Ekzekutive" sipas Akt Emërimit të datës 17.06.2019 me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lidhen nga marrëdhënia e saj e punës.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

## Arsyetim

Ankuesja e punësuar sipas Akt Emërimit të datës 17.06.2019 në Ministrinë e Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregëtisë në pozitën e punës "Asistente Ekzekutive" në zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm, më datë 27.06.2023 ka parashtruar ankesë me numër të protokollit 4921/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër të referencës Ref. 02/Nr.148 të datës 19.06.2023 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregëtisë për transferim të përkohshëm, me pretendimet se Vendimi është nxjerrë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 03.07.2023 ka proceduar kërkesën e ankuesit për përgjigje në ankesë në Ministrinë së Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregëtisë. Ndërsa Këshilli, më datë 04.07.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova:** Ankesën me numër protokollit 4921/2023 të datës 27.06.2023 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër reference Ref.02/Nr.148 të datës 19.06.2023; Vendimin me numër reference Ref.02/Nr.60 të datës 17.06.2021; Vendimin me numër reference Ref. 02/Nr.40 të datës 16.02.2023; Vendimin me numër reference Ref.02/Nr.44 të datës 23.02.2023; Vendimin me numër reference Ref. 02/Nr.57 të datës 16.06.2021; Ndryshimin dhe Plotësimin e Akt Emërimit; Ligji Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik; Organogrami i Ministrisë së Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregëtisë; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 03.07.2023; Përgjigje në ankesë e datës 04.07.2023; Akt Emërimi i datës 17.06.2019; Formulari i përshkrimit të detyrave të punës i datës 01.04.2019.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar të gjitha provat bashkëngjitura në shkresat e lëndë dhe konstatuar që ankesa e ankueses, është e bazuar sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, nga administrimi i provave të bashkëngjitura në shkresat e lëndës, konstaton se ankuesja sipas Akt Emërimit të datës 17.06.2019 është e punësuar në pozitën e punës "Asistente Ekzekutive të Përgjithshme", në Zyren e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregëtisë, ndërsa me Vendimin me numër të referencës Ref.02/Nr.148 të datës 19.06.2023 të nxjerrë nga Sekretari i Përgjithshëm ankuesja është caktuar për një periudhë tre (3) mujore në arkivë për shkak të vëllimit të madhë të punëve.

Ankuesja në ankesën me numër protokollit 4921/2023 të datës 27.06.2023 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër të referencës Ref. 02/Nr.148 të datës 19.06.2023 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregëtisë, pretendon se ky transferim i përkohshëm është bërë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi konkretisht nenin 5,6 dhe 7 të Rregullores Nr. (QRK) Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë, sepse e njëjta nuk është njoftuar paraprakisht nga njësia në të cilën do të transferohej, si dhe pozita në të cilën është transferuar përkohësisht në raport me pozitën e përhershme të cilën e mbanë sipas pretendimeve ankimore të ankueses është në kundërshtim me

Rregulloren (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, e gjithashtu sipas pretendimeve ankimore të ankueses Vendimi me numër të referencës Ref. 02/Nr.148 të datës 19.06.2023 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregëtisë, është në kundërshtim edhe me nenin 47 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative sepse nuk përmban elementet e aktit administrativ konkretisht arsyetimin dhe këshillën juridike.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ngritura në ankesë, Kolegji ju referua dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 2 paragrafin 2.1 ku përcaktohet se: *Nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozitë tjetër të Shërbimit Civil të së njëjtës kategori, në këto raste: 1.1. kur është në interes të institucionit, deri në 6 muaj gjatë 2 vjetëve. Transferimi mund të bëhet: 2.1. brenda institucionit ku është emëruar, duke përfshirë këtu edhe degët e tij lokale, dhe nenit 5 paragrafit 2 të Rregullores (QRK) Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë ku është përcaktuar se: "Transferimi i përkohshëm në interes të institucioni, miratohet nga njësi përgjegjëse, e cila njofton me shkrim nëpunësin civil që do të transferohet. Për marrjen e këtij vendimi njësi përgjegjëse mbështetet në analizën e plotësimit nga ana e nëpunësit të kritereve të pozitës të punës ku ai kërkohet të transferohet", dhe rrjedhimisht Kolegji vlerëson se organi i punësimit ka të drejtë që nëpunësin civil ta transferojë përkohësisht për interes të institucionit, mirëpo në kuptim të nenit 52 paragrafi 7 të njëjtë ligj, si dhe nenit 5 paragrafi 2 të Rregullores Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil, Kolegji konstaton se transferimi i përkohshëm në interes të institucionit është në kompetence të njësisë përgjegjëse.*

Sipas dispozitave të nenit 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, njësi përgjegjëse në Ministrinë e Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregëtisë, është Njësia për Burime Njerëzore. Njësia e Burimeve Njerëzore, si njësi përgjegjëse në rastet e tilla njofton me shkrim nëpunësin civil që do të transferohet, dhe se për marrjen e këtij vendimi njësi përgjegjëse mbështetet në analizën e plotësimit nga ana e nëpunësit të kritereve të pozitës të punës ku ai kërkohet të transferohet.

Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lëndës ka gjetur se vendimi me numër të referencës Ref.02/Nr.148 të datës 19.06.2023 nuk është miratuar nga organi kompetent, gjegjësisht Njësia e Burimeve Njerëzore, rrjedhimisht sipas shkresave të lëndës nga organi i punësimit nuk është dhënë asnjë arsyetim në lidhje me marrjen e kompetencës së njësisë përgjegjëse nga udhëheqësi me i lartë administrativ. Po ashtu Kolegji i Këshillit nga administrimi i provave të bashkangjitura në shkresat e lëndës ka konstatuar se ankuesja nuk është njoftuar nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregëtisë me kërkesë paraprake në lidhje me transferimin e saj ashtu siç e përcaktohet me dispozitën ligjore të lartcekur, andaj në kuptim të dispozitave ligjore të lartpërmendura si dhe bazuar në këtë konstatim Kolegji i Këshillit vlerëson se vendimi për transferimin e përkohshëm të ankueses, respektivisht akti i kontestuar me numër të referencës Ref.02/Nr.148 të datës 19.06.2023 është nxjerr nga organi jo kompetent përkatësisht vendimi është nxjerr nga Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm e jo nga Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore si organ kompetent, dhe si i tillë është i paligjshëm në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafit 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, andaj mbi këtë baze pretendimi ankimor i ankueses është i drejt dhe i bazuar.



Po ashtu Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka konstatuar se ankueses lidhur me rastin e transferimit nuk i është cekur pozita aktuale dhe po ashtu nuk i është cekur pozita se ku do të transferohet, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se në Vendimin me Ref.02/Nr.148 të datës 19.06.2023 të Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm është përcaktuar që „ankuesja për shkak të vëllimit të madh të punëve në arkivë, caktohet për një periudhë tre mujore”, e që është në kundërshtim me dispozitat e nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë ku është përcaktuar që: *“Nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozitë tjetër të Shërbimit Civil të së njëjtës kategori, në këto raste: 1.1. kur është në interes të institucionit, deri në 6 muaj gjatë 2 vjetëve”*, si dhe në kundërshtim me Ligjin Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, Rregulloren Nr. (QRK) Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë si dhe Rregulloren (QRK) Nr. 10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, sepse edhe përkundër faktit që në pajtim me dispozitën e nenit 52 të Ligji Nr. 06/L - 114 për Zyrtarët Publikë thuhet në mënyrë të përgjithësuar se *„Nëpunësi civil mund të transferohet përkohësisht në një pozitë tjetër të Shërbimit Civil të së njëjtës kategori”,* njësia përgjegjëse është e obliguar që në zbatimin e kësaj dispozite të marr parasysh të gjitha specifikat e pozitës së lirë dhe plotësimin e kushteve ligjore të nëpunësit që transferohet respektivisht në rastin konkret me rastin e transferimit të ankueses kanë qene të obliguar që të merr parasysh kualifikimet dhe përgatitjen e ankueses në raport me përshkrimin e detyrave të punës dhe kërkesat specifike të vendit të punës ku është transferuar nëpunësja.

Sa i përket pretendimit ankimor të ankueses e cila pretendon se Vendimi me numër reference Ref. 02/Nr.148 i datës 19.06.2023 i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregëtisë, nuk përmban elementet e aktit administrativ sipas nenit 47 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se Vendimi me numër reference Ref. 02/Nr.148 i datës 19.06.2023 i atakuar me ankesë nuk përmban të gjitha elementet e aktit administrativ konkretisht në preambulë nuk është përshkruar baza ligjore respektivisht nuk është përshkruar neni 52 paragrafi 1.1 i Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, po ashtu vendimi nuk e përmban saktë pjesën urdhëruese (dispozitivin), ndërsa fare nuk përmban pjesën arsyetuese dhe këshillën juridike, ashtu siç parashihet me nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *“Akti administrativ i shkruar përmban: 1.1. pjesën hyrëse, që tregon emrin e organit publik që ka nxjerrë aktin, bazën ligjore, emrin e atij të cilit i drejtohet akti, shënim të shkurtër të lëndës së procedurës dhe datën e nxjerrjes; 1.2. pjesën urdhëruese (dispozitivin), që tregon çfarë është vendosur si dhe afatin, kushtin, detyrimin dhe shpenzimet e procedurës, nëse është i zbatueshëm. Dispozitivi mund të ndahet edhe në më shumë pika. Shpenzimet e procedurës përcaktohen në pikë të veçantë të dispozitivit. 1.3. pjesën arsyetuese (në vijim: arsyetimin); 1.4. pjesën përmblylëse, që tregon kohën e hyrjes në fuqi të aktit, informatat për mjetet juridike, përfshirë organin publik apo gjykatën ku paraqitet mjeti juridik administrativ apo gjyqësor, formën e mjetit, afatin përkatës dhe mënyrën e llogaritjes së tij (këshillën juridike). Në rast kur ushtrimi i ankesës administrative, sipas ligjit, nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ, pjesa përmblylëse gjithashtu duhet të përmbajë këtë informacion, si dhe bazën ligjore për një përjashtim të tillë”*, kështu që pretendimi i ankuese është i bazuar.

Andaj, bazuar si me lartë, e në vështrim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, 1.3 dhe 1.5 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit konstaton se Vendimi me numër reference Ref. 02/Nr.148 i datës 19.06.2023 i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregëtisë është akt administrativ i paligjshëm, kështu që me qëllim të kthimit të ligjshmërisë, duke u bazuar në nenin 55 paragrafët 1 të Ligjit Nr. 05/L-031

për Procedurën e Përgjithshëm Administrative, si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi për aprovimin e ankesës dhe rrjedhimisht shfuqizimin e aktit administrativ të kontestuar, duke detyruar njëkohësisht organin e punësimit që ankuesen ta kthej në pozitën e saj sipas Akt Emërimit të datës 17.06.2019 me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lidhen nga marrëdhënia e saj e punës.

Në rast të moszbatimit të Vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerret veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.


Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
*Lënda me numër A.nr.886/2023*

Kaltrina Avdullahi-Prenaj

  
Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

  
Kryetare e Kolegjit



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankueses
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregëtisë;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregëtisë dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.